



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:003234

Datë: 15.04.2024

Numri i dokumentit: 05573984

C.nr.5/21

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEGA NË ISTOG, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni për Çështje Civile, me gjyqtaren Lirika Sylaj, në çështjen juridike - kontestimore të paditësit I.D me adresë të banimit në fshatin V., rruga “Z.A” nr.30, Komuna e I., kundër të paditurit G.K – avokat nga Istogu, sipas bazës juridike kompensim dëmi, vlera e kontestit 630 €, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me datën 03.04.2024, në prezencën e paditësit dhe të autorizuarës të të paditurit, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit I.D , ashtu që DETYROHET i padituri G.K – avokat nga Istogu që në emër dëmit të shkaktuar nga moskthimi i mjeteve – parave të përfaqësimit, t’ia kompensoj paditësit shumën prej 630.00 Euro me kamatë ligjore prej 8 % në vit, nga dita e parashtrimit të padisë e deri tek pagesa definitive, të gjitha këto brenda afatit 15 ditësh pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Kërkesëpadia dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Në këtë gjykatë, me datën 11.01.2021, është inicuar padia e paditësit I. D kundër të paditurit G.K avokat nga Istogu, sipas bazës juridike kompensim i dëmit. Në padi paditësi ka theksuar se me të paditurin kanë qenë në raport avokat – klient ku i padituri e ka përfaqësuar paditësin gjatë gjithë procedurës gjyqësore të zhvilluar pranë Gjykatës Themelore në Pejë – Dega në Istog sipas lëndës me nr. C.nr.139/16 e deri në përfundimin e saj, për çka i padituri rregullisht dhe në mënyrë të plotë për shërbimet e tij është paguar nga paditësi. Ka shtuar se lidhur me procedurën gjyqësore të mëparshme gjykata e shkallës së parë dhe ajo e shkallës së dytë kanë vendosur në favor të këtui paditësit duke i’u njohur të njëjtit edhe shpenzimet

procedurale në shumën prej 630 Euro, ku tutje, i padituri me autorizimin e paditësit e ka zhvilluar procedurën e përmbarimit nga e cila janë relizuar mjetet në llogari të paditurit, i cili nuk i ka kthyer këto mjete te paditësi duke këmbëngulur se kjo shumë me të drejtë i takon avokatit.

Përgjatë seancave gjyqësore dhe në fjalën përfundimtare, paditësi ka deklaruar se me të paditurin gjithmonë ka pasur raporte të mira dhe ndaj tij janë përmbushur të gjitha obligimet, madje, edhe ditën kur janë prishur raportet në mes tyre, i padituri nuk i ka thënë paditësit se i njëjti i ka borxh por vetëm kur paditësi i ka kërkuar të paditurit që t'ia jap parat, i padituri ka thënë se këto para i takojnë avokatit duke i propozuar më pas që këto mjete të ndahen 50/50, por që paditësi nuk i ka pranuar. Në kuptim të lartëcekurave duke i dorëzuar gjykatës dy vendime e komisionit disiplinor të odës së avokatëve të Kosovës, me të cilat i padituri është shpallur përgjegjës, gjykatës i ka propozuar që të aprovohet kerkesëpadija e paditësit dhe të detyrohet i padituri që t'ia kompensoj shumën e mjeteve në vlerë prej 630 Euro me kamatë të cilën e paguajnë bankat vendore si deponim në kursim me afat përtej një viti pa destinimin të caktuar duke filluar nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Shenzimet procedurale i ka kërkuar.

Përfaqësuesja e autorizuar e të paditurit, në përgjigje në padi, seancat gjyqësore dhe fjalën përfundimtare e ka kundërshtuar në tërësi të gjitha pretendimet e paditësit, duke theksuar se paditësi ka kërkuar nga i padituri që të kryhen veprime në emër të tij, konkretisht, edhe pas marrjes së aktgjykimit i padituri ka vazhduar të punoj për paditësin dhe atë përpilimin e përgjigjes në ankesë ku sipas tarifës së odës së avokatëve arrin shumën prej 104 Euro, dalja në teren dy herë në shumën prej 104 Euro, propozimin për përmbarim në shumën prej 104 Euro, përpilimin e dy parashtrësive në shumën prej 104 euro, duke përfshirë edhe konsultat e shumta që ka pasur i padituri me paditësin e të cilat sipas tarifës së odës duhet të paguhen, mirëpo, lidhur me këto paditësi nuk e ka paguar asnjë shpenzim. Shton se, pasi që mjetet janë transferuar në llogari të të paditurit, paditësi ka shkuar në zyrën e avokatit me një arrogancë dhe nervozizëm të pakuptimtë duke i kërkuar të hollat dhe nuk ka dashur fare të diskutoj së paku për arritjen e ndonjë marrëveshje edhe pse të gjitha veprimet në procedurën e cila është zgjidhur në favor të paditësit, i ka kryer i padituri dhe i njëjti është munduar që këto veprime ti kryej me një çmim minimal edhe nën çmimet që i parasheh oda e avokatëve. Po ashtu deklaroi se i padituri është liruar nga përgjegjësia me vendimin e komisionit të ankesave me numër V.KA.nr.4-13/22 të datës 26.08.2022, prandaj, në kuptim të lartëcekurave, gjykatës i ka propozuar që padinë e paditësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Shpenzimet procedurale i ka kërkuar, varësisht nga rezultati i procedurës.

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike sipas propozimit të palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit dhe ka administruar provat si në vijim: aktgjykimi C.nr.139/16 i datës 29.09.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, aktgjykimi Ac.nr.4863/17 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i datës 21.05.2020,

detajet e transaksionit të datës 01.07.2020 në NLB Bank, propozimi për ekzekutimin e shpenzimeve procedurale i datës 17.06.2020, kërkesa për kompensimin e dëmit material e datës 02.12.2020, shkresa – përgjigjja e datës 08.12.2020, vendimet me numër V.KD.NR.4-3/2020 e datës 30.03.2022, V.KD.NR.4-10/22 i datës 15.07.2022 të Komisionit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe vendimi V.KA.Nr.4-13/22 i datës 26.08.2022 i Komisionit të Ankesave të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Pasi që gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, çmuarjes me kujdes të secilës provë e duke u mbështetur në dispozitat e nenit 8 të LPK-së, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko kontestimore duhet vendosur sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi pasi që me provat e administruara gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

-Nga Aktgjykimi C.nr.139/16 i datës 29.09.2017 i lëshuar nga Gjykata Themelore në Pejë - Dega në Istog, u vërtetua se gjykata e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit M.D për lirimin dhe dorëzimin e palujtshmërisë së uzurpuar, duke e detyruar të njëjtin që të paditurit **I.D** t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 630 Euro.

-Nga Aktgjykimi Ac.nr.4863/17 i Gjykatës së Apelit të Kosovës, i datës 21.05.2020 u vërtetua se gjykata e shkallës së dytë e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, ndërsa Aktgjykimin C.nr.139/16 të datës 29.09.2017 e ka vërtetuar.

-Nga detajet e transaksionit vërtetohet se me datën 01.07.2020 në xhirollogarinë e të paditurit janë transferuar mjetet në vlerë prej 630 Euro, në emër të shpenzimeve procedurale të aprovuara nga gjykata me Aktgjykimin C.nr.139/16, pas paraqitjes së propozimit për ekzekutimin e mjeteve tek permbaruesi privat.

-Nga vendimet e Komisionit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës V.KD.4-3/2020 i datës 30.03.2022 dhe vendimi numër V.KD.NR.4-10/22 i datës 15.07.2022, vërtetohet se i padituri është shpallur përgjegjës për shkelje të rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga kolegji disiplinor i OAK-së, për shkak të moskthimit të parave të përfaqësimit të njohura me vendimin e gjykatës së shkallës së parë dhe asaj të shkallës së dytë.

-Ndërsa, nga vendimi i Komisionit të Ankesave të Odës së Avokatëve të Kosovës V.KA.Nr. 4 - 13/22 i datës 26.08.2022, u vërtetua se komisioni i ankesave duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurit kundër vendimit të komisionit disiplinor, ka marr vendim me të cilin e ka ndryshuar vendimin e kolegjit disiplinor të OAK-së dhe e ka hedhur propozimin e prokurorit disiplinor, për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes disiplinore.

Baza ligjore

Në këtë çështje juridike kontestimore gjykata ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr.04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, konkretisht nenin, 136 paragrafi 1, në të cilin përcaktohet se *“Kush i shkakton tjetrit dëm ka për detyrë ta kompensojë, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”*. Në bazë të këtij principi pala përgjigjet për dëmin e shkaktuar

me dashje dhe nga pa kujdesia. Tutje neni 137 paragrafi 1 ku parashihet se “*Dëmi është zvogëlimi i pasurisë së dikujt (dëm i zakonshëm) dhe pengimi i rritjes së saj (fitimi i humbur), si dhe shkaktimi tjetrit i dhembjes fizike, vuajtjes psikike ose frikës (dëmi jo material)*. E në ndërlidhje me keto, dispozita e nenit 174 paragrafi 1 parasheh “*Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që janë shkaktuar pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë shpërblimin në një shumë e cila është e nevojshme që gjendja materiale e të dëmtuarit të sillet në atë gjendje në të cilën do të kishte qenë po të mos kishte veprim dëmtues ose mosveprim*”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar dhe se duke u bazuar në dispozitat ligjore të cituara më lartë, e njëjta duhet të aprovohet.

Fillimisht, gjykata ka konstatuar se për palët ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se shuma e mjeteve në vlerë prej 630 Euro e realizuar nga procedura e përmbarrimit, në emër të shpenzimeve procedurale të njohura me Aktgjykimin C.nr.139/16 e të vertetuara me aktgjykimin Ac.nr.4863/17, janë transferuar në xhirollogarinë bankare të të paditurit dhe se i njëjti këto mjete nuk i ka dorëzuar tek paditësi.

Mirëpo, për gjykatën dhe palët në këtë çështje rezultoi kontestues vetëm fakti se a kishte bazë dhe të drejtë i padituri që këto mjete ti mbaj dhe pavarësisht kërkesës së paditësit mos t’ia dorëzoj të njëjtit.

Në bazë të provave të administruara në këtë procedurë, është vërtetuar se këtu paditësi dhe i padituri në procedurë të mëhershme gjyqësore ishin në raport klient – avokat dhe nga ky raport të paditurit i janë tranferuar në xhirollogarinë e tij shuma e mjeteve në vlerë prej 630 Euro në emër të shpenzimeve procedurale të cilat gjykata e shkallës së parë dhe ajo e dytë i’a kishte njohur këtu paditësit. Këto mjete i padituri pavarësisht kërkesës së paditësit për kthimin e tyre, nuk i ka dorëzuar tek paditësi me pretendimin se këto mjete i takojnë avokatit për veprimet të cilat i njëjti i ka ndërmarr si i autorizuar. Megjithatë, gjykata konstatoj se një mënyrë e tillë e mbajtjes së këtyre mjeteve është jo e drejtë dhe arbitrare. Se këto mjete janë mbajtur pa të drejtë nga i padituri është vërtetuar edhe nga vendimet e Komisionit Disiplinor të Odës së Avokatëve të Kosovës, me të cilat i padituri është shpallur përgjegjës për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave dhe autoritetit të avokatisë nga neni 118 paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 dhe 1.7 të Statutit të OAK-së e lidhur me nenin 44, 71 dhe 72 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, për shkak të moskthimit të parave të përfaqësimit.

Duke pasur parasysh raportin e mëparshëm të këtu palëve ndërgjyqëse, konkretisht raportin avokat – klient (palë), gjykata vlerëson se i padituri këto mjete i ka marr në llogari të palës dhe të njëjtat do të duhej ti kthente tek paditësi, e kjo mbështetur edhe në dispozitat e nenit 71 të Kodit të Etikës Profesionale të Avokatit, ku parashihet se “*Paratë që i ka marrë avokati për klientin, duhet pa vonesa t’ia dorëzojë atij në pajtim me legjislacionin në fuqi*” si dhe neni 72 ku parashihet se “*Nuk lejohet që ti ndalë apo përdorë parat të cilat i janë dhënë me destinim të*

caktuar përveç nëse mes palës dhe avokatit ka kontratë për shërbimet dhe shpenzimet. Rekomandohet që kontrata të lidhet me shkrim”.

Në kuptim kësaj, gjykata i konsideroj si të pabazuara pretendimet e përfaqësueses të të paditurit se këto mjete i padituri i ka mbajtur për shkak të veprimeve procedurale të cilat i ka ndërmarr në emër të paditësit pas marrjes së aktgjykimit, kjo pasi që nuk është provuar me asnjë provë konkrete, që i padituri me të drejtë i ka mbajtur mjetet me të cilat do të legjitimohej veprimi i tij, e kjo, nisur nga fakti se barra e të provuarit bie mbi palët ndërgjyqëse, kjo duke iu referuar nenit 7 paragrafi 1 i LPK-së, ku thuhet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

E edhe në situatën tjetër, në qoftëse i padituri nuk është kompensuar për veprimet e tij të ndërmarra si i autorizuar i paditësit, përmbushjen e detyrimit mund ta kërkonte dhe realizonte në forma dhe procedura të tjera të parapara për përmbushjen e detyrimit e jo si në rastin konkret përmbushjen ta realizoj në mënyrë arbitrare.

Gjykata i ka pasur parasysh dhe në të njëjtën kohë i ka vlerësuar edhe provat dhe pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse (përveç atyre të cekura më lartë), përfshirë këtu edhe vendimin e komisionit të ankesave me të cilin vendim për shkak të arritjes së parashkrimit absolut të ndjekjes disiplinore është ndryshuar vendimin e kolegjit disiplinor V.DK.nr.4-10/2022 të datës 15.07.2022 dhe është hedhur propozimin e prokurorit disiplinor të OAK-së, mirëpo erdhi në përfundim se të njëjtat nuk kanë ndikim në vendosjen meritore të çështjes kontestuese.

Meqenëse i padituri, ka rënë në vonesë, gjykata me propozimin e paditësit dhe në bazë të ligji në fuqi vendosi duke u mbështetur në dispozitën e nenit 382 paragrafi 2 të LMD-së ku është paraparë se: *“Lartësia e kamatëvonesës është tetë për qind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë”*, ndërsa si datë nga e cila rrjedh detyrimi i të paditurit për pagesën e kamatës gjykata ka caktuar datën e parashtrimit të padisë.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është bazuar në dispozitën e nenit 450 të LPK, ashtu që secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEGA NË ISTOG
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni për Çështje Civile
C.nr.5/21, datë 03.04.2024

Gj y q t a r j a
Lirika Sylaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditësh, pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.